

P.nr. 166/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti i krimeve të rënda, në përbërje nga gjyqtari Sali Berisha në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mahije Rama, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.H, nga fshati V.K. Deçan, për vepër penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës PP.nr. 198/2016 dt. 04.08.2016., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e të akuzuarit dhe prokurorit të shtetit Haxhi Sinanaj, në bazë të nenit 248 par 4 të KPPK-së, me dt. 30.01.2016, mur dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari F.H, i lindur me në fshatin V K. Deçan nga babai A dhe nëna F e gjinisë Q , ka të kryer shkollën e ... i gjendjes së ekonomike, i përkatësisë Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLET FAJTOR

Për shkak se:

Me parë ka siguruar e gjerë me dt. 01.02.2016 rreth orës 14:39 min në bjeshkën e Baballoqit K. Deçan pa autorizim ka mbajtur armë dhe atë një pushkë gjuetie cal. 12 mm. prodhim Turk me numër serik TS870BD-N-12/76 e me të cilën armë i njëjti ishte vërejtur duke kaluar rrugës në bjeshkët e Baballoqit nga APK-së ku me të marr informacionin hetuesit policore arrin të bëjnë identifikimin e të dyshuarit ku edhe konfiskojnë armën në fjalë.

-Me çka ka kryer vepër penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 par.1 të KPK-së,

Ashtu që gjykata në bazë të nenit, neni 7, 17, 21, 22, 41, 45, 46, 50, 51, 62, 69, 73, 74, të KPK-së, dhe 374 par. 1 të KPK-së, si dhe neni 365. të KPPK-së;

G J Y K O H E T

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6(gjashtë) muajve, me kusht për 1 (një) vit e ashtu që ky dënim nuk do të ekzekutohet fare në qoftë se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit nuk do të kryen ndonjë vepër të re penale.

Gjykata konform nenit 374 par.3 KPK-së e konfiskon armen e sekuestruar dhe atë një pushkë gjuetie cal. 12 mm. prodhim Turk me numër serik TS870BD-N-12/76 e cila do të urdhërohen që të shkartohej konform nenit 10 b të referencës administrative 2004/05 pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sipas rastit në polici 2016 DC-144.

I akuzuari obligohet në shpenzimet gjyqësorë në lartësi prej 25 euro dhe në paushallin gjyqësor në lartësi prej 25 euro, gjithsejtë 50 euro. që të gjitha në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 453 par. 1 të KPPK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore-DKR në Pejë, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr. 45/16 dt. 04.03.2016, kundër të akuzuarit F.H, nga fshati V. K. Deçan, për vepër penale mbajtje ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armës nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i akuzuari F.H, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës, duke kërkuar mundësin e zbutjes së masës së dënimit.

Në seancën e shqyrtimit fillestarë meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, Prokurori i shtetit mbetet pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj sipas aktakuzës, duke kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në shpenzime të procedurës penale si dhe i propozon gjykatës që të merret arma e konfiskuar nga policia.

Gjykata gjatë vlerësimit të pranimit të fajësisë së të akuzuarit ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore nga neni 248 par. 1 pika 1, 2, 3 e 4, të KPPK-së, për çka gjykata nuk lëshohet në procedimin e provave në bazë të nenit 248 par. 4. të KPPK-së, nga se konsideron se pranimi i fajësisë është bërë në mbështetje të fakteve të çështjes që i përmban aktakuza dhe të materialeve të prezantuara nga prokurori të cilat gjinden në shkresat e lëndës, vërtetimi mbi konfiskimin e armës, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera të lëndës.

Në Gjykatë gjatë tërë procedurës penale nuk është paraqitur asnjë rrethanë e cila do të përjashtonte apo do të zvogëlonte përgjegjësinë penale të të akuzuarit për çka nga gjykata konsiderohet se i njëjti është personalisht përgjegjës.

Gjatë përcaktimit të masës së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat relevante që ndikuan në llojin dhe lartësinë e saj, si peshën dhe rrethanat kryerjes së veprës penale, rrezikshmërinë shoqërore të saj dhe konform nenit 73 par 2 dhe 3, pika 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7, si dhe par. 5 të njëjtit nenë dhe nenit 74 par. 3 pika 3.9, 3.10 dhe 3.11 të KPK-së, ku si rrethana lehtësuese vlerësohet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, sjellja dhe

qëndrimi pendues, dhe sjellja e mëparshme akuzuarit, fakti se më parë nuk ishte i dënuar për ndonjë veprë penale si dhe rrethanat ekonomike në të cilat jeton. Ndërsa si rrethana rënduese vlerësohet shkalla e lartë e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Me gjithat gjatë vlerësimit të këtyre rrethanave me rastin e matjes së dënimit të shqiptuar, Gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë si rrethanë relevante duke u përcaktuar për dënimin në minimumin e parashikuar ligjor, me bindjen se edhe me këtë masë të dënimit të shqiptuar do të arrihet qëllimin i ndëshkimit dhe e konsideron si dënim adekuat me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer dhe në përpjesëtim të drejt me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, që do të ndikoi pozitivisht në ndërgjegjësimin e tij në të ardhmen, në drejtimin e preventivës individuale dhe të asaj gjenerale, e që është edhe vet qëllimi i këtij dënimi në kuptim të dispozitës së nenit 41 par. 1.1, 1.2, 1.4 të KPK-së.

Gjykata konform nenit 374 par.3 KPK-së e konfiskon armen e sekuestruar dhe atë një pushkë gjuetie cal. 12 mm. prodhim Turk me numër serik TS870BD-N-12/76 e cila do të urdhërohen që të shkartohej konform nenit 10 b të referencës administrative 2004/05 pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi sipas rastit në polici 2016 DC-144.

I akuzuari obligohet në shpenzimet gjyqësore në lartësi prej 25 euro dhe në paushallin gjyqësor në lartësi prej 25 euro, gjithsejtë 50 euro. që të gjitha në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 453 par. 1 të KPPK-së.

Andaj nga sa u tha më lartë e në bazë të dispozitave të lartëcituara ligjore dhe konform nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË -DKR, PRK.P.nr.166/2016, të dt. 30.01.2017

Procesmbajtësja,
Mahije Rama,

Kryetari i trupit gjykues,
Sali Berisha, d.v.

KESHILLA JURIDIKE:

Pala e pakënaqur ka të drejt ankese Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate, në afatin prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.